

LIGJ
Nr. 45/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “QYTETARËT, BARAZIA, TË DREJTAT DHE
VLERAT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Qytetarët, barazia, të drejtat dhe vlerat”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 9.5.2024.

Shpallur me dekretin nr. 181, datë 21.5.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.



Bruksel, 14.8.2023

C(2023) 5436 përfundimtare
Shtojcë

SHTOJCË

E VENDIMIT TË KOMISIONIT PËR MIRATIMIN, NËNSHKRIMIN DHE ZBATIMIN E
PËRKOHSHËM TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, NGA NJËRA ANË, DHE BASHKIMIT EVROPIAN, NGA ANA TJETËR,
PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “QYTETARËT,
BARAZIA, TË DREJTAT DHE VLERAT”

MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NGA NJËRA ANË, DHE BASHKIMIT
EVROPIAN, NGA ANA TJETËR, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
PROGRAMIN “QYTETARËT, BARAZIA, TË DREJTAT DHE VLERAT”

Qeveria e Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar si “Shqipëria”), nga njëra anë, dhe Komisioni Evropian (në vijim i referuar si “Komisioni”), në emër të Bashkimit Evropian, nga ana tjetër, në vijim të referuara si “Palët”,

duke pasur parasysh Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Bashkimit Evropian¹, që përcakton se termat dhe kushtet specifike në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të veçantë, në veçanti kontributi i pagueshëm financiar, do të përcaktohet me marrëveshje ndërmjet Komisionit, që vepron në emër të Bashkimit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë²;

duke pasur parasysh se programi i Bashkimit Evropian, “Qytetarët, barazia, të drejtat dhe vlerat” (në vijim i referuar si “Programi”) është krijuar me rregulloren (BE) 2021/692 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 28 prill 2021 për programin për “Qytetarët, barazinë, të drejtat dhe vlerat” dhe shfuqizon rregulloren (BE) nr. 1381/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe rregulloren e Këshillit (BE) nr. 390/2014³ (në vijim i referuar si “Rregullorja (BE) 2021/692”);

duke pasur parasysh se termat dhe kushtet specifike të asociimit duhet të përcaktohen nga një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendit të asociuar;

duke ndarë objektivin e përgjithshëm të Programit, i cili është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave dhe i vlerave të parashikuara në traktatet e BE-së, Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së dhe konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në fuqi, në veçanti, duke mbështetur organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesuara që veprojnë në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe duke inkurajuar pjesëmarrjen qytetare dhe demokratike, në mënyrë që të mbështeten dhe zhvillohen më tej shoqëri të hapura, të bazuara në të drejta, demokratike, të barabarta dhe gjithëpërfshirëse, të bazuara në sundimin e ligjit;

duke njohur parimet e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren (BE) 2021/692;

duke marrë në konsideratë se si partnerë kryesorë, duhet të kërkohet aderimi i vendeve të asociuara me objektivat e Programit dhe që sipas Rregullores (BE) 2021/692, vendet e treta duhet të synojnë të marrin pjesë plotësisht në Program; megjithatë siç specifikohet nga neni 14 paragrafi 2 (a) (ii) i asaj Rregulloreje, një vend i tretë i lidhur me Programin është i pranueshëm, përveç në lidhje me objektivin specifik të përmendur në pikën (a) të nenit 2 (2) (Vlerat e Bashkimit Evropian);

duke marrë në konsideratë qëllimet e përbashkëta, vlerat dhe lidhjet e forta të Palëve në fushën e angazhimit demokratik dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në të kaluarën nëpërmjet pjesëmarrjes në Programin Evropa për Qytetarët dhe Programin për të Drejtat, Barazinë dhe Qytetarinë;

duke njohur dëshirën e përbashkët të palëve për të zhvilluar, për të forcuar, për të nxitur dhe për të zgjeruar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e tyre në fushën e barazisë, të të drejtave dhe barazisë gjinore, pjesëmarrjes demokratike të qytetarëve, të të drejtave dhe parandalimit dhe luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve, të rinjve dhe grupeve të tjera në rrezik, kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Qëllimi i asociimit

1. Shqipëria do të marrë pjesë si vend i asociuar dhe do të kontribuojë në të gjitha fushat e Programit të përmendura në nenin 2 të Rregullores (BE) 2021/692 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, përveç vlerave specifike të Unionit të përmendura në pikën (a) të nenit 2(2) të asaj Rregulloreje, në versionin e saj më të përditësuar.

Neni 2

Termet dhe kushtet e pjesëmarrjes në Program

¹ OJ L 192, 22.7.2005, p. 2.

² Kjo marrëveshje ndërkombëtare përbën dhe ka të njëjtat efekte ligjore si një memorandum mirëkuptimi i përcaktuar në Marrëveshjen e Përgjithshme për termat dhe kushtet e pjesëmarrjes në programet e Komunitetit.

³ OJ L 156, 5.5.2021, p. 1.

1. Shqipëria do të marrë pjesë në Program në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje, në aktin ligjor të përmendur në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në çdo rregull tjetër që lidhet me zbatimin e Programit, në versionet e tyre më të përditësuara.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në termat dhe kushtet e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, personat juridikë të vendosur në Shqipëri mund të marrin pjesë në masat e Programit, sipas kushteve të vlefshme me ato të zbatueshme për personat juridikë të vendosur në Union, përfshirë respektimin e masave kufizuese të BE-së.⁴

3. Përfaqësuesit e Shqipërisë kanë të drejtë të marrin pjesë si vëzhgues në komitetin e përmendur në nenin 22 të Rregullores (BE) 2021/692, pa të drejtë vote dhe për pikat që lidhen me Shqipërinë. Komiteti mbledhet pa praninë e përfaqësuesve të Shqipërisë në momentin e votimit. Shqipëria do të informohet për rezultatin.

4. Shpenzimet e udhëtimit dhe të jetesës të bëra nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për të marrë pjesë si vëzhgues në punën e komitetit të përmendur në nenin 22 të Rregullores (BE) 2021/692 ose në takime të tjera që lidhen me zbatimin e Programit, do të rimbursohen nga Bashkimi Evropian mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.

5. Palët do të bëjnë çdo përpjekje, brenda kuadrit të dispozitave ekzistuese, për të lehtësuar lëvizjen dhe qëndrimin e lirë të pjesëmarrësve në aktivitetet e mbuluara nga kjo Marrëveshje dhe për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve të synuara për përdorim në aktivitete të tilla.

6. Shqipëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme, sipas rastit, për të garantuar që mallrat dhe shërbimet, të blera në Shqipëri ose të importuara në Shqipëri, të financohen pjesërisht ose tërësisht në përputhje me marrëveshjet e grantit dhe/ose kontratat e lidhura për realizimin e aktiviteteve, në përputhje me këtë Marrëveshje, të përjashtohen nga detyrimet doganore, detyrimet e importit dhe tarifatat e tjera fiskale, përfshirë TVSH-në, të zbatueshme në Shqipëri.

7. Gjuha angleze do të përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3 **Kontributi financiar**

1. Pjesëmarrja e Shqipërisë ose e subjekteve juridike shqiptare në Program do të jetë subjekt i kontributit financiar të Shqipërisë në Program dhe i kostove përkatëse të menaxhimit, zbatimit dhe funksionimit në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Unionit (në vijim i referuar si “Buxheti i Unionit”).

2. Kontributi financiar do të marrë formën e:

- a) një kontributi operacional; dhe
- b) një tarife pjesëmarrjeje.

3. Kontributi financiar do të jetë në formën e një pagese vjetore të kryer me një kësht, në përputhje me kërkesën e thirrjes për fonde dhe do të paguhet jo më vonë se 45 ditë pas datës së thirrjes.

4. Kontributi operacional do të mbulojë shpenzimet operative dhe mbështetëse të Programit dhe do të jetë shtesë si në ndarjet e angazhimeve, edhe në pagesat ndaj shumave të regjistruara në buxhetin e Unionit, të miratuara përfundimisht për Programin.

5. Kontributi operacional do të bazohet në një kontribut kyç të përcaktuar si raporti i Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të Shqipërisë me çmimet e tregut ndaj PBB-së së Unionit me çmimet e tregut. PBB-të, me çmimet e tregut që do të aplikohen, do të përcaktohen nga shërbimet e dedikuara të Komisionit bazuar në të dhënat më të fundit statistikore të disponueshme për llogaritjet e buxhetit në vitin para vitit kur duhet paguar pagesa vjetore. Rregullimet për këtë kontribut janë përcaktuar në shtojcën I.

⁴ Masat kufizuese të BE-së miratohen në bazë të Traktatit për Bashkimin Evropian ose Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

6. Kontributi operacional do të llogaritet duke zbatuar çelësin e kontributit, të rregulluar, për ndarjet e angazhimeve të përfshira në buxhetin e Bashkimit Evropian, të miratuara përfundimisht për vitin e zbatueshëm për financimin e Programit.

7. Tarifa e pjesëmarrjes do të jetë 4% e kontributit operacional vjetor të llogaritur në përputhje me paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni dhe do të përfshihet në fazë, siç përcaktohet në shtojcën I. Tarifa e pjesëmarrjes nuk do t'u nënshtrohet rregullimeve ose korrigjimeve retrospektive.

Unioni do t'i japë Shqipërisë informacion në lidhje me pjesëmarrjen e saj financiare, siç përfshihet në informacionin buxhetor, kontabël, performancën dhe vlerësimin që u jepet autoriteteve buxhetore dhe ekzekutuese të Unionit, në lidhje me Programin. Ky informacion do të jepet duke pasur parasysh rregullat e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave të BE dhe të Shqipërisë dhe nuk cenon informacionin që Shqipëria ka të drejtë të marrë sipas shtojcës II.

8. Të gjitha kontributet e Shqipërisë ose pagesat nga Unioni, si dhe llogaritja e shumave të detyrimeve ose atyre që do të merren, do të bëhen në euro.

Neni 4

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

1. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Gjykatës së Audituesve të Bashkimit Evropian, në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë Program do të monitorohet vazhdimisht mbi bazën e partneritetit që përfshin Komisionin dhe Shqipërinë.

2. Rregullat në lidhje me menaxhimin e shëndetshëm financiar, përfshirë kontrollin financiar, rikuperimin dhe masat e tjera kundër mashtrimit, në lidhje me financimin Unionit, sipas kësaj Marrëveshjeje, përcaktohen në shtojcën II.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga data 1 janar 2023. Ajo do të mbetet në fuqi për aq kohë sa është e nevojshme për të gjitha projektet dhe masat dhe aktivitete të financuara nga Programi, të gjitha veprimet e nevojshme për të mbrojtur interesat financiarë të Bashkimit Evropian dhe të plotësohen të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet Palëve.

3. Bashkimi Evropian dhe Shqipëria mund ta zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht, në përputhje me procedurat dhe legjislacionin e tyre të brendshëm përkatës. Zbatimi i përkohshëm do të fillojë në datën kur Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

4. Nëse Shqipëria njofton Komisionin që vepron në emër të Unionit se nuk do të përfundojnë procedurat e saj të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të pushojë së zbatuari përkohësisht në datën e marrjes së këtij njoftimi nga Komisioni, i cili do të përbëjë datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

5. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje mund të pezullohet nga Bashkimi Evropian në rast të mospagesës së kontributit financiar, që duhet paguar nga Shqipëria në përputhje me pikën II, paragrafin 3 të shtojcës I.

Pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do t'i njoftohet Shqipërisë nga Bashkimi Evropian me një letër zyrtare njoftimi, e cila do të hyjë në fuqi 30 ditë pas marrjes së këtij njoftimi nga Shqipëria.

Në rast se zbatimi i kësaj Marrëveshjeje pezullohet, personat juridikë të vendosur në Shqipëri nuk do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e dhënies së kontratës që nuk kanë përfunduar ende kur pezullimi hyn në fuqi. Procedura e dhënies së kontratës do të konsiderohet e përfunduar, kur si rezultat i kësaj procedure, janë ndërmarrë angazhime ligjore.

Pezullimi nuk prek detyrimet ligjore të lidhura me personat juridikë të vendosur në Shqipëri përpara hyrjes në fuqi të pezullimit. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë të zbatohet për këto angazhime ligjore.

Bashkimi Evropian do të njoftojë menjëherë Shqipërinë, pasi të jetë marrë prej saj e gjithë shuma e kontributit financiar ose operacional që duhet paguar. Pezullimi do të hiqet me efekt të menjëhershëm pas këtij njoftimi.

Që nga data e heqjes së pezullimit, subjektet juridike të Shqipërisë do të kenë sërish të drejtë të marrin pjesë në procedurat e dhënies së kontratës të filluara pas kësaj date dhe në procedurat e dhënies së kontratës të filluara përpara kësaj date, për të cilat nuk kanë skaduar afatet për paraqitjen e aplikimeve.

6. Secila palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje në çdo kohë me një njoftim me shkrim që informon për synimin për ta ndërprerë atë.

Ndërprerja do të hyjë në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës kur njoftimi me shkrim i arrin marrësit. Data kur ndërprerja hyn në fuqi do të përbëjë datën e ndërprerjes për qëllimet e kësaj Marrëveshje.

7. Kur kjo Marrëveshje pushon së zbatuari përkohësisht në përputhje me paragrafin (4) ose ndërpritet në përputhje me paragrafin (6), Palët bien dakord që:

a) projektet, masat, aktivitetet në lidhje me të cilat janë marrë angazhime ligjore gjatë zbatimit të përkohshëm dhe/ose pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dhe përpara se kjo Marrëveshje të pushojë së zbatuari ose të ndërpritet, do të vazhdojnë deri në plotësimin e tyre, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

b) kontributi financiar vjetor i vitit N gjatë të cilit kjo Marrëveshje pushon së zbatuari përkohësisht ose ndërpritet, do të paguhet tërësisht në përputhje me nenin 3.

Palët do të zgjidhin me pëlqimin e përbashkët çdo pasojë tjetër të ndërprerjes ose të përfundimit të zbatimit të përkohshëm të kësaj Marrëveshjeje.

8. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e përbashkët të Palëve. Hyrja në fuqi e ndryshimeve do të ndjekë të njëjtën procedurë si ajo e zbatueshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

9. Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të hartohet në dy kopje, në anglisht dhe shqip, ku secili tekst është njëloj autentik.

Në rast të mospërputhjes në interpretim, teksti në anglisht do të prevalojë.

Bërë në Tiranë, sot, e mërkurë, në datën 27 dhjetor, në vitin 2023

Për Shqipërinë

Bërë në Bruksel, sot, e hënë, në datën 27 nëntor në vitin 2023

Për Unionin

SHTOJCA I: Rregullat që rregullojnë kontributin financiar të Shqipërisë në programin “Qytetarët, barazia, të drejtat dhe vlerat” (2021–2027)

SHTOJCA II: Menaxhimi i shëndetsëm financiar

SHTOJCA I

RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “QYTETARËT, BARAZIA, TË DREJTAT DHE VLERAT” (2021–2027)

I. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar i Shqipërisë në Program do të përcaktohet mbi baza vjetore në përpjesëtim me dhe si shtesë me shumën e disponueshme çdo vit në buxhetin e Unionit për angazhimet buxhetore të nevojshme për menaxhimin, zbatimin dhe funksionimin e Programit.

2. Tarifa e pjesëmarrjes e përmendur në nenin 3(7) të kësaj Marrëveshjeje do të ndahet, si më poshtë:

- 2023: 1.5%;
- 2024: 2%;
- 2025: 2.5%;
- 2026: 3%;
- 2027: 4%.

3. Në përputhje me nenin 3(5) të kësaj Marrëveshjeje, kontributi operacional që duhet paguar nga Shqipëria për pjesëmarrjen e saj në Program do të llogaritet për vitet financiare përkatëse, duke aplikuar një rregullim në çelësin e kontributit.

Rregullimi i çelësit të kontributit do të jetë:

Çelësi i kontributit i rregulluar = Çelësi i kontributit x koeficientin

Koeficienti i përdorur për llogaritjen e mësipërme për të rregulluar çelësin e kontributit do të jetë 0.25.

II. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Komisioni do t'i komunikojë Shqipërisë, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se data e thirrjes së parë për fonde të vitit financiar, informacionin e mëposhtëm:

a) shumat në ndarjet e angazhimeve në buxhetin e Unionit të miratuara përfundimisht për vitin në fjalë për linjat buxhetore që mbulojnë pjesëmarrjen e Shqipërisë në Program;

b) shumën e tarifës së pjesëmarrjes të përmendur në nenin 3(7) të kësaj Marrëveshjeje.

Në bazë të projektbuxhetit të tij, Komisioni do të paraqesë një vlerësim të informacionit për vitin pasardhës sipas pikave (a) dhe (b) sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se deri më 1 shtator të vitit financiar.

2. Komisioni do të nxjerrë jo më vonë se muaji prill i çdo viti financiar, një thirrje për fonde për Shqipërinë që korrespondon me kontributin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

Çdo thirrje për fonde do të parashikojë pagesën e kontributit të Shqipërisë jo më vonë se 45 ditë pas nxjerrjes së thirrjes për fonde.

Për vitin e parë të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni do të lëshojë një thirrje të vetme për fonde, brenda 60 ditësh nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

3. Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar, sipas kësaj Marrëveshjeje në përputhje me pikën II të kësaj shtojce. Në mungesë të pagesës nga Shqipëria brenda datës së caktuar, Komisioni do të dërgojë një letër zyrtare kujtese.

Çdo vonesë e pagesës së kontributit financiar do të sjellë detyrimin e Shqipërisë për të paguar kamatëvonesë, në shumën që përputhet me tejkalimin e afatit të pagesës.

Norma e interesit për shumat e arkëtueshme të papaguara në datën e caktuar do të jetë norma e aplikuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç është publikuar në serinë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie data e skadimit, e rritur me tri pikë pesë pikë përqindjeje.

Në rast se vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë ndjeshëm zbatimin dhe menaxhimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të pezullohet nga Komisioni në mungesë të pagesës 20 ditë pune pas një letre zyrtare kujtese, pa cenuar detyrimet e Unionit sipas marrëveshjeve të granteve dhe/ose kontratave të lidhura tashmë mbi zbatimin e veprimeve indirekte për të cilat është përzgjedhur Shqipëria.

SHTOJCA II MENAXHIMI I QËNDRUESHËM FINANCIAR MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARE DHE RIKUPERIMI

Neni 1

Rishikimet dhe auditimet

1. Bashkimi Evropian ka të drejtë të kryejë, në përputhje me aktet e zbatueshme të një ose më shumë institucioneve ose organeve të Unionit dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse, rishikime dhe auditime teknike, shkencore, financiare ose lloje të tjera në ambientet e çdo personi fizik me banim ose të çdo subjekti juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr financim nga Bashkimi Evropian, si dhe çdo palë të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të Unionit me banim ose të vendosur në Shqipëri. Rishikimi dhe auditime të tilla mund të kryhen nga agjentët e institucioneve dhe organet e Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, ose nga persona të tjerë të caktuar nga Komisioni Evropian.

2. Agjentët e institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian, në veçanti të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, si dhe personat e tjerë të caktuar nga Komisioni Evropian, do të

kenë aksesin e duhur në mjediset e punës, punët dhe dokumentet (si në format elektronik edhe në versionet në letër) dhe të gjithë informacionin e kërkuar për të kryer kontrole të tilla, duke përfshirë të drejtën për të marrë një kopje fizike/elektronike dhe ekstrakte nga çdo dokument ose përmbajtjen e çdo mjeti të dhënash të mbajtur nga personi fizik ose juridik i audituar, ose nga pala e tretë e audituar.

3. Shqipëria nuk do të parandalojë ose ngrejë ndonjë pengesë të veçantë për të drejtën e hyrjes në Shqipëri dhe për hyrjen në ambient të agjentëve dhe personave të tjerë të përmendur në paragrafin 2, për arsye të ushtrimit të detyrave të tyre të përmendura në këtë nen.

4. Rishikimet dhe auditimet mund të kryhen, gjithashtu, pas pezullimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 5(5) të saj, përfundimi i zbatimit të përkohshëm ose ndërprerja e saj, në kushtet e përcaktuara në aktet e zbatueshme të një ose më shumë akteve të institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian dhe siç parashikohet në marrëveshjet dhe/ose kontratat përkatëse në lidhje me çdo angazhim ligjor që zbaton buxhetin e Bashkimit Evropian të hyrë nga Bashkimi Evropian përpara datës në të cilën pezullimi i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me nenin 5(5) të saj), përfundimi i zbatimit të përkohshëm ose ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje hyn në fuqi.

Neni 2

Lufta kundër parregullsive, mashtrimeve dhe veprave të tjera penale që prekin interesat financiarë të Unionit

1. Komisioni Evropian dhe Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) do të autorizohen që të kryejnë hetime administrative, duke përfshirë kontrole dhe inspektime në vend, në territorin e Shqipërisë. Këto hetime do të kryhen në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuar nga aktet në fuqi të një ose më shumë institucioneve të BE-së.

2. Autoritetet kompetente shqiptare do të informojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in brenda një kohe të arsyeshme për çdo fakt ose dyshim që është konstatuar në lidhje me një parregullsi, mashtrim ose aktivitet tjetër të paligjshëm, që prek interesat financiarë të Unionit.

3. Kontrollat dhe inspektimet në vend mund të kryhen në ambientet e çdo personi fizik me banim ose person juridik të vendosur në Shqipëri dhe që merr fondet e Bashkimit, si dhe të çdo pale të tretë të përfshirë në zbatimin e fondeve të BE-së që banon në Shqipëri.

4. Kontrollat dhe inspektimet në vend do të përgatiten dhe kryhen nga Komisioni Evropian ose OLAF-i, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetin kompetent shqiptar të caktuar nga qeveria shqiptare. Autoriteti i caktuar do të njoftohet në një kohë të arsyeshme përpara për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontroleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mund të ofrojë ndihmë. Për këtë qëllim, zyrtarët e autoriteteve kompetente shqiptare mund të marrin pjesë në kontrollat dhe inspektimet në vend.

5. Me kërkesë të autoriteteve shqiptare, kontrollat dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me Komisionin Evropian ose OLAF-in.

6. Agjentët e Komisionit dhe stafi i OLAF-it do të kenë akses në të gjithë informacionin dhe dokumentacionin, duke përfshirë të dhënat kompjuterike, mbi operacionet në fjalë, të cilat kërkohen për kryerjen e duhur të kontroleve dhe inspektimeve në vend. Ata, në veçanti, mund të kopjojnë dokumentet përkatëse.

7. Kur personi, subjekti ose një palë tjetër e tretë i reziston një kontrolli ose inspektimi në vend, autoritetet shqiptare, duke vepruar në përputhje me rregullat dhe rregulloret kombëtare, do të ndihmojnë Komisionin Evropian ose OLAF-in për t'i lejuar të përmbushin detyrën e tyre në kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në vend. Kjo ndihmë do të përfshijë marrjen e masave të duhura paraprake sipas legjislacionit kombëtar, veçanërisht për të mbrojtur provat.

8. Komisioni Evropian ose OLAF-i do të informojnë autoritetet shqiptare për rezultatin e këtyre kontroleve dhe inspektimeve. Në veçanti, Komisioni Evropian ose OLAF-i do t'i raportojnë sa më shpejt të jetë e mundur autoritetit kompetent shqiptar çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi që është vënë re gjatë kontrollit ose inspektimit në vend.

9. Pa cenuar zbatimin e legjislacionit penal shqiptar, Komisioni Evropian mund të vendosë masa administrative dhe penalitete ndaj personave juridikë ose fizikë të Shqipërisë që marrin pjesë në zbatimin e një programi ose aktiviteti në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

10. Për qëllime të zbatimit të duhur të këtij neni, Komisioni Evropian ose OLAF-i dhe autoritetet kompetente shqiptare do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të njëres prej palëve në këtë Marrëveshje, do të konsultohen me njëra-tjetrën.

11. Për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv dhe shkëmbimin e informacionit me OLAF-in, Shqipëria ka caktuar si pikë kontakti njësinë përgjegjëse për inspektimin financiar publik (Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë), në rolin e Shërbimit të Koordinimit të Antimashtrimit. Shqipëria do të njoftojë Komisionin Evropian dhe OLAF-in për çdo modifikim të kësaj pike kontakti.

12. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet Komisionit Evropian ose OLAF-it dhe autoriteteve kompetente shqiptare do të bëhet, duke pasur parasysh kërkesat e konfidencialitetit. Të dhënat personale të përfshira në shkëmbimin e informacionit do të mbrohen në përputhje me rregullat në fuqi.

13. Autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë me Prokurorinë Publike Evropiane për ta lejuar atë të përmbushë detyrën e saj për të hetuar, ndjekur penalisht dhe sjellë në gjykim autorët dhe bashkëpunëtorët e veprave penale që prekin interesat financiare të Bashkimit Evropian, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Rikuperimi dhe zbatimi

1. Vendimet e miratuara nga Komisioni Evropian që vendosin një detyrim financiar ndaj personave juridikë ose fizikë të ndryshëm nga Shtetet, në lidhje me çdo pretendim që rrjedh nga Programi, duhet të jenë të zbatueshme në Shqipëri. Urdhri i ekzekutimit i bashkëlidhet vendimit, pa asnjë formalitet tjetër përveç verifikimit të origjinalitetit të vendimit nga autoriteti kombëtar i caktuar për këtë qëllim nga Qeveria e Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë do t'i bëjë të njohur Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian autoritetin e saj të caktuar kombëtar. Në përputhje me nenin 4 të kësaj shtojce, Komisioni Evropian ka të drejtë të njoftojë vendime të tilla të detyrueshme drejtpërdrejt personave që banojnë dhe subjekteve juridike të vendosur në Shqipëri. Zbatimi do të kryhet në përputhje me ligjin dhe rregullat e procedurës shqiptare.

2. Vendimet dhe urdhrat e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, të dhëna në zbatim të një klauzole arbitrazhi të përfshirë në një kontratë ose marrëveshje, në lidhje me programet e Unionit, aktivitetet, veprimet ose projektet e BE-së, do të jenë të zbatueshme në Shqipëri në të njëjtën mënyrë si vendimet e Komisionit Evropian të përmendura në paragrafin 1.

3. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian do të ketë juridiksion për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Komisionit të përmendur në paragrafin 1 dhe për të pezulluar zbatimin e tij. Megjithatë, gjykatat e Shqipërisë do të kenë juridiksion për ankesat se zbatimi po kryhet në mënyrë të parregullt.

Neni 4

Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit

Institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian të përfshira në zbatimin e Programit, ose në kontrollet mbi këtë Program, kanë të drejtë të komunikojnë drejtpërdrejt, duke përfshirë përmes sistemeve elektronike të shkëmbimit, me çdo person fizik që banon ose person juridik të vendosur në Shqipëri dhe merr fondet e Unionit, si dhe çdo palë e tretë e përfshirë në zbatimin e fondeve të Unionit me banim ose vendosur në Shqipëri. Këta persona, subjekte dhe palë mund t'u dorëzojnë drejtpërdrejt institucioneve dhe organeve të Bashkimit Evropian të gjithë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që u kërkohet të dorëzojnë në bazë të legjislacionit të Bashkimit Evropian, të zbatueshëm për programin e BE-së dhe të kontratave ose marrëveshjeve të lidhura për zbatimin e këtij Programi.